

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Tremujori I, 2016

Tiranë, më 03 Qershor 2016: Në tremujorin e parë 2016, indeksi i kushtimit në ndërtim (për banesa) arriti 101,9 % kundrejt tremujorit të parë 2011 (Tremujori i parë 2011=100).

Në tremujorin e parë 2016 ndryshimi vjetor i indeksit të kushtimit në ndërtim (për banesa) është -0,2 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 0,4 %.


Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2015, uljen më të madhe e ka patur grupi “Shpenzime transporti” me 3,3 %, pasuar nga grupi “Shpenzime për energji” me 0,4 %.

Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2015, rritja më e madhe vjetore vërehet në grupin “Shpenzime për paga” me 1,6 %, pasuar nga grupi “Shpenzime materiale” me 1,2 %.

Në tremujorin e parë 2016 ndryshimi tremujor i indeksit është - 0,4 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2015, uljen më të madhe e ka patur grupi “Shpenzime transporti” me 2,7 %. Indeksi i çmimeve të grupit “Shpenzime për energji” është ulur me 0,4 % dhe indeksi i çmimeve të grupit “Shpenzime makinerie” është ulur me 0,2 %, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2015, indeksi i grupit “Shpenzime materiale” u rrit me 0,9 %. Brenda këtij grupi, nëngrupi “Materiale ndërtimi” u rrit me 1,9 %, ndërsa nëngrupi “Materiale elektrike dhe komunikimi” u ul me 2,8 % dhe nëngrupi “Materiale hidro-sanitare” u ul me 1,0 %.

Fig. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) sipas tremujorëve



Tab. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Tremujori i parë 2011=100

%

Kodi	Grupet	Peshat	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14	II-14	III-14	IV-14	I-15	II-15	III-15	IV-15	I-16
	Totali (1+2+3+4+5+6)	100,0	101,5	101,7	101,6	102,2	101,7	102,0	102,1	102,3	102,1	102,4	102,5	102,3	101,9
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	55,2	100,1	100,3	101,2	100,7	99,8	100,8	101,3	101,6	99,0	99,7	100,0	99,3	100,2
	a. Materiale ndërtimi	42,3	99,6	100,4	101,6	100,8	99,9	101,1	101,6	101,8	98,5	99,0	99,3	98,6	100,4
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	6,7	101,6	100,7	100,1	102,0	99,7	100,1	101,4	101,7	100,8	101,9	102,5	102,3	99,4
	c. Materiale hidro-sanitare	6,2	102,0	98,9	99,1	99,2	99,5	99,5	99,6	100,2	100,4	101,6	101,8	101,0	99,9
2	Shpenzime për paga	24,6	99,9	101,7	102,6	102,4	103,5	103,9	103,8	104,0	104,1	104,4	105,4	105,6	105,7
3	Shpenzime makinerie	8,3	102,9	105,2	104,6	104,4	102,1	102,9	103,1	103,0	102,8	103,1	103,0	102,9	102,8
4	Shpenzime transporti	5,3	102,4	103,7	102,8	102,6	102,8	103,1	103,4	103,3	103,1	102,9	102,8	102,5	99,8
5	Shpenzime për energji	2,1	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	99,4	99,4	99,4	99,4	99,1
6	Kosto të tjera	4,5	103,7	103,1	101,7	102,1	105,6	104,8	103,6	103,9	107,6	106,7	105,4	106,1	108,3

Tab. 2. Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Kodi	Grupet	I-13/I-12	II-13/II-12	III-13/III-12	IV-13/IV-12	I-14/I-13	II-14/II-13	III-14/III-13	IV-14/IV-13	I-15/I-14	II-15/II-14	III-15/III-14	IV-15/IV-14	I-16/I-15
	Totali (1+2+3+4+5+6)	1,2	1,0	0,5	1,2	0,2	0,2	0,5	0,1	0,4	0,4	0,4	0,03	-0,2
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	0,3	-0,3	0,1	0,8	-0,3	0,5	0,1	0,9	-0,8	-1,1	-1,3	-2,3	1,2
	a. Materiale ndërtimi	-0,3	-0,4	0,0	1,1	0,3	0,7	-0,1	1,0	-1,4	-2,0	-2,2	-3,2	1,9
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	2,3	1,6	0,8	3,4	-1,8	-0,6	1,3	-0,3	1,1	1,8	1,1	0,6	-1,4
	c. Materiale hidro-sanitare	2,1	-1,9	-1,0	-3,8	-2,4	0,6	0,5	1,0	0,9	2,1	2,2	0,8	-0,5
2	Shpenzime për paga	-0,9	1,1	1,4	2,6	3,6	2,1	1,1	1,6	0,6	0,6	1,6	1,6	1,6
3	Shpenzime makinerie	2,0	3,2	0,7	1,5	-0,8	-2,1	-1,5	-1,3	0,7	0,2	0,0	-0,1	-0,1
4	Shpenzime transporti	1,9	2,0	0,4	0,0	0,4	-0,6	0,5	0,6	0,3	-0,2	-0,6	-0,7	-3,3
5	Shpenzime për energji	0,3	0,3	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,9	-0,8	-0,8	-0,8	-0,4
6	Kosto të tjera	2,5	2,2	1,4	0,9	1,9	1,6	1,8	1,8	1,9	1,8	1,7	2,1	0,6

Tab. 3 . Ndryshimet tremujore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Kodi	Grupet	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14	II-14	III-14	IV-14	I-15	II-15	III-15	IV-15	I-16
	Totali (1+2+3+4+5+6)	0,5	0,2	-0,1	0,6	-0,5	0,3	0,1	0,2	-0,2	0,3	0,1	-0,1	-0,4
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	0,1	0,2	0,9	-0,5	-0,9	1,0	0,5	0,3	-2,5	0,7	0,3	-0,7	0,9
	a. Materiale ndërtimi	-0,1	0,8	1,2	-0,8	-0,9	1,2	0,5	0,2	-3,2	0,5	0,3	-0,8	1,9
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	3,0	-0,9	-0,6	1,9	-2,3	0,4	1,3	0,3	-0,9	1,0	0,6	-0,1	-2,8
	c. Materiale hidro-sanitare	-1,1	-3,0	0,2	0,1	0,3	0,1	0,1	0,6	0,2	1,3	0,2	-0,8	-1,0
2	Shpenzime për paga	0,0	1,9	0,9	-0,2	1,1	0,4	-0,1	0,2	0,1	0,3	0,9	0,2	0,1
3	Shpenzime makinerie	0,0	2,2	-0,5	-0,2	-2,2	0,8	0,1	-0,1	-0,2	0,3	-0,1	-0,1	-0,2
4	Shpenzime transporti	-0,3	1,3	-0,8	-0,2	0,2	0,2	0,3	-0,1	-0,1	-0,2	-0,1	-0,3	-2,7
5	Shpenzime për energji	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,8	0,0	0,0	0,0	-0,4
6	Kosto të tjera	2,5	-0,5	-1,4	0,4	3,4	-0,8	-1,2	0,3	3,5	-0,9	-1,2	0,7	2,1

Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjerë joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. IKN duke filluar nga tremujori i parë 2011 llogaritet me shportën e re të materialeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimi., Tremujori i parë i vitit 2011 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 71 zëra nga të cilat 66 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mblidhen nga 165 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 65 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Për llogaritjen e Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0t}^L = \frac{\sum_{i=1}^n \left(\frac{P_t^i}{P_0^i} \times w_0^i \right)}{\sum_{i=1}^n w_0^i} \times 100$$

Ku:

I_{ot} = Indeksi i periudhës t krahasuar me periudhën bazë 0

P_t^i = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën t (periudha korente)

P_0^i = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën 0 (periudha bazë)

w_0^i = Pesha e artikullit i në periudhën bazë

Rishikimi

Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë etj.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me tremujorin e mëparshëm.